VENDIM
Nr. 204, datë 30.3.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 686, DATË 29.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PËRGJEGJËSIVE E TË AFATEVE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM) DHE PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË VENDIMIT E DEKLARATËS MJEDISORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun I bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 3, fjalët "... jo më vonë se 2 (dy) ditë pune ..." zëvendësohen me "... brenda ditës ...";

b) Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

i. fjalët "... brenda 7 (shtatë) ditëve punë ..." zëvendësohen me "... brenda 2 (dy) ditëve punë ...";

ii. fjalët "... brenda 30 (tridhjetë) ditëve punë ..." zëvendësohen me "...brenda 20 (njëzet) ditëve punë ...";

c) Fjalia hyrëse e pikës 4/2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"AKM-ja, kur vlerëson se dokumentacioni i aplikimit apo dokumentacioni i plotësuar është i plotë, sipas pikës 1, të këtij kreu, brenda 2 (dy) ditëve punë nga marrja e aplikimit apo plotësimit të dokumentacionit, ia përcjell atë institucioneve të mëposhtme, të cilat japin mendimin e tyre brenda 4 (katër) ditëve punë:";

ç) Në pikën 5, fjalët "... brenda 2 (dy) ditëve punë nga data e marrjes së ..." zëvendësohen me "... brenda ditës nga marrja e ...";

d) Në pikën 7, fjalët "... brenda 22 (njëzet e dy) ditëve punë ..." zëvendësohen me "... brenda 10 (dhjetë) ditëve punë ...";

dh) Pas pikës 9 shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:

"9/1. AKM-ja ia përcjell brenda ditës informacionin apo dokumentacionin e plotësuar nga zhvilluesi institucioneve të konsultuara në pikën 9, të këtij kreu, të cilat shprehin mendimin e tyre mbi informacionin shtesë brenda 2 (dy) ditëve punë.";

e) Pika 12 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"12. Afati maksimal për dërgimin e vendimit te zhvilluesi është 12 (dymbëdhjetë) ditë pune nga aplikimi pranë ministrisë. Në rastet e plotësimit të dokumentacionit, duke llogaritur afatet sipas pikave 4 dhe 9, të këtij kreu, afati maksimal për dërgimin e vendimit te zhvilluesi është 14 (katërmbëdhjetë) ditë pune, duke mos llogaritur këtu afatin që i duhet subjektit zhvillues për të kryer plotësimin e dokumentacionit. Në rast se zhvilluesi nuk plotëson

dokumentacionin/informacionin brenda afateve të përcaktuara në pikën 9, nënkupton që zhvilluesi ka hequr dorë nga aplikimi për VNM-në paraprake.”.

2. Në kreun II bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3, fjalët “... jo më vonë se 2 (dy) ditë pune ...” zëvendësohen me “... brenda ditës ...”;

b) Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

i. fjalët “... brenda 7 (shtatë) ditëve punë ...” zëvendësohen me “... brenda 2 (dy) ditëve punë ...”;

ii. fjalët “... brenda 30 (tridhjetë) ditëve punë ...” zëvendësohen me “... brenda 20 (njëzet) ditëve punë ...”;

c) Në pikën 4/2 bëhen këto ndryshime:

i. fjalët “... brenda 5 (pesë) ditëve punë ...” zëvendësohen me “... brenda 2 (dy) ditëve punë ...”;

ii. fjalët “... brenda 7 (shtatë) ditëve punë ...” zëvendësohen me “... brenda 4 (katër) ditëve punë ...”;

ç) Në pikën 5, fjalët “... brenda 2 (dy) ditëve punë nga data e marrjes së ...” zëvendësohen me “... brenda ditës nga marrja e ...”;

d) Në pikën 7, fjalët “... është 25 ditë pune ...” zëvendësohen me “... është 12 (dymbëdhjetë) ditë pune ...”;

dh) Në pikën 11, fjalët “... brenda 3 (tri) ditëve punë ...” zëvendësohen me “... brenda 2 (dy) ditëve punë ...”;

e) Në pikën 12, fjalët “... brenda 5 (pesë) ditëve punë ...” zëvendësohen me “... brenda 3 (tri) ditëve punë ...”;

ë) Në pikën 13, fjalët “... brenda 30 (tridhjetë) ditëve punë ...” zëvendësohen me “... brenda 20 (njëzet) ditëve punë ...”;

f) Në pikën 14, fjalët “... brenda 7 (shtatë) ditëve punë ...” zëvendësohen me “... brenda 5 (pesë) ditëve punë ...”.

3. Në pikat 2 dhe 4, të kreut III, fjalët “... brenda 10 (dhjetë) ditëve ...” zëvendësohen me “... brenda 7 (shtatë) ditëve ...”.

II. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama